



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS

**Njoftim Përqendrimi**

**Rasti: Bashkim i ndërmarrjes Fitzroy Merger CO, tërësisht e kontrolluar nga  
CTH Invest S.A., me Ferrara Candy Company Holdings Inc.**

Në datën 16.10.2017, me shkresën Nr. 422 Prot., Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin në lidhje me një transaksion financiar që realizon bashkimin e Ferrara Candy Company Holdings Inc (Target-Ferrara) me Fitzroy Merger Co (Fitzroy), shoqëri e bashkimit e kontrolluar prej CTH Invest S.A (Blerësi-CTH).

Ky njoftim bëhet për shkak se Blerësi plotëson kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- CTH Invest SA, është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Belgjikës, me adresë në Place de la Sainte-Alliance 16, B-1180 Uccle-Belgjikë, me nr 0660.681.450 RPM Bruksel. Objekti<sup>1</sup> i kësaj ndërmarrjeje, është përmeshja sipas formës së tyre e të gjitha aktiviteteve industriale, tregtare, financiare, drejtpërdrejtë ose tërthorazi në lidhje me krijimin, menaxhimin dhe financimin e çdo shoqërie, objekt i të cilave është kryerja e cilësdo nga operacionet, pavarësisht nga forma e tyre, si dhe nga menaxhimi i përhershëm ose i përkohshëm, i portofolave të krijuara për këtë qëllim. Ndërmarrja mund të bashkëpunojë ose të marrë pjesë ose të interesohet për shoqëritë e tjera, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në çfarëdo mënyre. Gjithashtu ajo mund të veprojë si administrator apo likuidues në shoqëri të tjera. Ndërmarrja mund të kryejë në përgjithësi çdo aktivitet tregtar, industrial, financiar, të luajtshëm ose të paluajtshëm që ka lidhje direkte ose në mënyrë të tërthortë me qëllimin e shoqërisë ose që mund të lehtësojë realizimin e saj.
- Shitësi/Ndërmarrja Target: Ferrara Candy Company Holdings, Inc. Është një shoqëri e themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të shtetit të Delaware, me seli në adresën One Tower Lane, Suite 2700 Oakbrook Terrace, State of Delaware, IL 60181, SHBA, rregjistruar në regjistrin tregtar të Delaware me Nr 5139840. Targeti ushtron aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave.
- .

---

<sup>1</sup> Sipas Statutit të Ndërmarrjes CTH depozituar më 13 Prill 2017,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)